

**AKT THEMELIMI DHE STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SELECTOURS"SH.P.K**

Shoqëria "SELECTOURS" SH.P.K themelohet ne baze te iniciatives dhe kapitalit themeltar te aksionereve themelues .

Ortakët themelues te shoqërise:

1. Neritan Dunicari me ID I75213014U

Ne perputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare Te Regjistrimit", te ndryshuar.

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Emri i Shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar është "SELECTOURS"SH.P.K

Shoqëria është person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e Aktit te Themelimit e te ketij Statuti.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

2.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

1. Guide Turistike.
2. Operator Turistik.
3. Agjensi Turistike.
4. Transport Udhetarësh.

2.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si kontraktor i përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontrakttoi palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha punimeve.

2.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit te shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

2.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoi drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptarë apo të huaja, si edhe të hyje ne marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose te huaj.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqëria ka seline e saj ne adresen me Rruga Durrësit, pallati 240 Shkalla 4, Ap. 47

Aktiviteti i shoqërisë do te zhvillohet ne Tirane dhe do te shtrihet ne te gjithë territorin shtetror te Republikës se Shqipërisë dhe jashte saj.



NENI 4
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat te papercaktuar, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimeve te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise .

NENI 5
DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortaket e Shoqerise duhet te kryejne depozitim e kapitalit themeltar per llogari te Shoqerise ne nje banke te caktuar prej tyre.

NENI 6
TRANSFERIMI I KUOTAVE

Ortaket mund te kalojne pjese nga kapitali themeltar subjekteve dhe personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne Neni 73 te Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare".

Ne rast shitje kuotash Ortaket aktual kane te drejten e parablerjes. Pasi eshte permbushur kjo pike, e drejta e parablerjes se Ortakeve aktual, vetem atehere Ortaket mund ti ofrojne kuotat e tyre Shoqerive dhe personave te tjere jashte shoqerise.

NENI 7
PARAQITJA KONTABILE

Operacionet e Shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor.

Ne mbyllje te cdo viti Ortaket ose personi i ngarkuar prej tyre, bejne inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe hartojne raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e Shoqerise gjate vitit financiar.

NENI 8
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 (njqind) Leke, dhe eshte i ndare ne 1 kuote me vleren nominale 100 lek. E zoteruar 100 % nga Z. Neritan Dunicari.

NENI 9
OPERACIONET FINANCIARE

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

NENI 10
BLERJET E SHOQERIVE

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e Shoqerise. Ne Republikën e Shqipërisë, Shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

NENI 11
FONDI REZERVE

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e saj. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga Ortaket ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te Shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne Leke, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë. Bilanci dhe perllogaritjet ekonomike te Shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.



NENI 12
PLANET FINANCIARE

Aktiviteti i Shoqërisë mbi bazën e programeve financiare që bëjnë pjesë në aktivitetin financiar të saj. Planet financiare parashikojnë koston dhe të ardhurat e shprehura në Leke. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do të paraqiten në Leke. Rezultatet financiare të aktivitetit dhe të punës së kryer nga Shoqëria, paraqiten në bilancin vjetor. Kursi i kembimit të monedhës shqiptare në monedhat e huaja dhe e kundërta do të jenë ato të vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

NENI 13
ORGANET E SHOQËRISE

Organi vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë
- b) ndryshimet e Statutit
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve
- ç) emërimin e shkarkimin i Likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- e) miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë
- i) çështjet e tjera të parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij Neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c) investime
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 14
ORGANET E SHOQËRISE

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga Ligji 9901 date 14.04.2008, nga Ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratorët apo Ortakët e përcaktuar sipas Neni 84 të këtij Ligji.

Asambleja e Përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultoni ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të Shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një Ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të Shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij Neni, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e Administratorëve.

NENI 15 MËNYRA E THIRRJES

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet në Statut, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë Ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij Neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë Ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16 KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në Statut, mund t'i drejtojnë Administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta Ortakë kanë të drejtë ta thërrasin Asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të Neni 83 të këtij Ligji.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij Neni dhe thirrja i është njoftuar Ortakëve, Administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e Neni 14 të Statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të Ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të Ortakut të përfaqësuar.

NENI 17 PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një Ortak tjetër apo nga një person i tretë.


Administratorët e Shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i Ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 18 KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë Ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Neni 87 të Ligji 9901 date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse Ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të Neni 88 të këtij Ligji.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij Neni, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



NENI 19
MARRJA E VENDIMEVE

Me përjashtim të rasteve kur Statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 e votave të Ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të Neni 86 të Ligji 9901 date 14.04.2008, për ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligj ose në Statut, për çështjet e tjera të renditura në Neni 81 të Ligjit Per Shoqerite Tregtare, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të Ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi Ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë Ligj ose në Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut përkatës.

NENI 20
PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse Shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në këtë faqe.

NENI 21
ADMINISTRATORI

Shoqëria administrohet nga nje ose disa persona fizike. Administratori i Shoqërisë emrohet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë. Afati i qendrimit në detyrë të Administratorit është për një periudhë 5 (pese) vjetecare.

Administrator i Shoqërie caktohet **Z. Neritan Dunicari**

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhenie me të tretet në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh Ligji shprehimisht Asamblesë ose të tremeve. Administratori ka përgjegjësi ndaj Shoqërisë ose ndaj të tremeve për shkelje të Ligjeve, Statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administratimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogaritë vjetore etj.

NENI 22
RASTET E PUNES

Raportet e punës ndërmjet Shoqërisë, filialeve dhe agjensive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në baze të Kontrates së Punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në keto Kontrata, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 23

Shoqëria merr përsipër, të shlyej rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislacioni për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

NENI 24
PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

Shoqëria nuk prishet kur njeri prej ortakëve falimenton, behet i paafte ose vdes. Shoqëria prishet:

1.Me kalimin e afatit për kohezgjatjen e saj.



2. Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
3. Me vendim gjykate.
4. Me hapje te procedurave te falimentit.

NENI 25
LIKUJDIMI

Likujdimi i Shoqerise behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

NENI 26
KUSHTET E TJERA

Te gjitha vendimet e mara nga Asambleja evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e Shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete Statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne Ortaket si dhe Ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Per regjistrimin e Shoqerise dhe depozitimim e akteve prane QKR, autorizohet Administratori i saj.

Nënshkruar, sot më datë 29/06/2021

ORTAKET THEMELUES

NERITAN DUNICARI

Neriton Dunicari

